



ODA EKONOMIKE
E KOSOVËS

KOSOVA CHAMBER
OF COMMERCE



American Chamber of Commerce in Kosovo



KDWW-OEGJK

Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare



European
Investors
Council



KLUBI I PRODHUESVE TË KOSOVËS
KOSOVO MANUFACTURING CLUB

Anketë mbi ndikimin e COVID-19 në ndërmarrjet në Kosovë

Prill 2020

Analiza e të dhënave është
realizuar pro-bono nga:



Hyrje

- Ky studim është inicuar dhe realizuar bashkërisht nga:
 - Oda Ekonomike e Kosovës
 - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
 - Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare
 - Këshilli i Investitorëve Evropianë
 - Klubi i Prodhuesve të Kosovës
- Studimi është ndërmarrë për të fituar një pasqyrë preliminare të ndikimit të pandemisë COVID-19 në ndërmarrjet Kosovare
- Studimi është realizuar nga odat në periudhën 1-8 prill 2020 përmes anketimit online.
- Duhet pasur parasysh se anketa është realizuar gjatë javës së tretë të kufizimeve si rezultat i pandemisë dhe si rezultat opinionet e paraqitura reflektojnë vetëm situatën fillestare dhe mund të mos reflektojnë drejtë zhvillimet e mëtutjeshme të shkaktuara nga kriza shëndetësore.

Përshkrimi i demografisë së të anketuarve

Anketa paraqet opinionet e ndërmarrjeve anëtare të odave përkatëse në Kosovë.

Nga rreth 4,000 kontakte online shkalla e përgjigjes ka qenë 462, që është një shkallë përgjigjeje prej 11% e cila konsiderohet shumë e mirë në anketimet online.

Numri i të punësuarve të deklaruar nga respondentët në studim 36,940 të punësuar.

Niveli i tatimeve të paguara gjatë vitit 2019 nga një pjesë e respondentëve (262 respondentë) është deklaruar në nivel prej 232 milion Euro – që mund të shërbejë si një proxy për peshën ekonomike të mostrës së respondentëve.

OPSIONET	PËRGJIGJET	
Prodhim	45.89%	212
Tregti me shumicë	18.61%	86
Tregti me pakicë	20.78%	96
Energji	1.73%	8
Miniera	1.08%	5
Ndërtimtari	9.52%	44
Shërbime HORECA	7.14%	33
Shërbime financiare	3.68%	17
Shërbime të këshillimit të bizneseve	4.55%	21
Shërbime të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimeve	5.63%	26
Shërbime të transportit të udhëtarëve dhe/ose turizmit	2.38%	11
Tjetër (Ju lutem specifikoni)	19.26%	89
Përgjigjet totale: 462		

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE

Gjetjet kryesore (1)

Perceptimi i ndikimit të krizës në biznese

- Sa i përket perceptimit të ndërmarrjeve të anketuara, 95% e tyre e kanë vlerësuar ndikimin e krizës së shkaktuar nga COVID-19 si negative (58.6% si shumë negative)
- Nëse e zërthejmë vlerësimin në bazë të madhësisë së ndërmarrjes, del se ndikimi negativ i COVID-19 rritet me rritjen e madhësisë së kompanisë (madhësia për nga numri i të punësuarve). Perceptimi është shumë i ngjashëm për të gjitha sektoret e përfaqësuara në mostër.

Ndikimi i krizës në aftësinë për të funksionuar

- Në pyetjen rreth ndikimit të COVID-19 në aktivitetin e ndërmarrjeve të anketuara dhe mënyrën se si po veprojnë 83.6% e ndërmarrjeve shprehen se kriza ka zvogëluar aftësinë e tyre për të punuar, ku 39% janë mbyllur tërësisht, 30.7% punojnë me kapacitet të reduktuar dhe 13.8% me orar të shkurtuar.
- Nëse e zërthejmë vlerësimin në bazë të madhësisë së ndërmarrjes, del se ndërmarrjet mikro janë më të prekura me mbyllje të plotë (54.4%), ndërsa ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha janë detyruar të punojnë me kapacitet të reduktuar (57.3% dhe 40% respektivisht)

Gjetjet kryesore (2)

Rrezikshmëria për mbijetesë

- Në pyetjen mbi mundësinë që kriza e shkaktuar nga COVID-19 të rrezikojë mbijetesën e kompanive 59.4% e ndërmarrjeve janë shprehur të brengosura për mbijetesën e tyre.
- Nëse e zërthejmë vlerësimin në bazë të madhësisë së ndërmarrjes, del se ka korelacion të zhdrejtë në mes të madhësisë dhe rrezikut për mbijetesë, ku ndërmarrjet mikro dhe ato të vogla perceptojnë rrezikun më të madh (65% e tyre kanë deklaruar se i është rrezikuar mbijetesesa).
- Sektori që ndihet më i rrezikuari për mbijetesë është ai i ndërtimtarisë, ku 75% e ndërmarrjeve ndihen të rrezikuara.

Gjetjet kryesore (3)

Ndikimi në punësim

- Për sa i përket ndikimit në punësim, 29.2% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se qysh në javën e tretë të krizës numri i të punësuarve është zvogëluar.
- 40.6% të ndërmarrjeve të mesme kanë deklaruar se kriza ka ndikuar në zvogëlimin e numrit të të punësuarve, ndërsa 33.3% e ndërmarrjeve të mëdha kanë deklaruar të njejtën gjë.
- Impakti në numrin e të punësuarve duket të jetë pak më i ulët te ndërmarrjet mikro (25.4%) dhe ato të vogla (25.5%).
- Ndërmarrjet e anketuara kanë deklaruar se vetëm gjatë 2-3 javët e para të krizës janë detyruar të largojnë nga puna 2,948 të punësuar
- Në pyetjen rreth proporcionit të fuqisë punëtore të pushuar nga puna, ky proporcion del të jetë më i ulët në kompanitë e mëdha (10% e kompanive deklarojnë se kanë larguar rreth 30% të të punësuarve). Megjithatë, duke pasur parasysh se këto ndërmarrje punësojnë më shumë persona si numër absolut, një pjesë e madhe e papunësisë pritet të gjenerohet nga problemet e këtyre ndërmarrjeve.
- Largimet më të mëdha nga puna observohen të ndërmarrjet mikro dhe të vogla ku 8.5% e ndërmarrjeve mikro kanë larguar në mes të 30-50% të fuqisë punëtore, ndërsa 13.9% të tyre kanë larguar mbi 50% të të punësuarve
- Ngjajshëm, 5% e ndërmarrjeve të vogla kanë larguar në mes 30-50% të të punësuarve, ndërsa 7.5% të këtyre ndërmarrjeve kanë larguar mbi 50% të fuqisë së tyre punëtore.
- 4.6% të ndërmarrjeve të anketuara kanë deklaruar se i kanë larguar të gjithë të punësuarit.

Gjetjet kryesore (4)

Aspektet më të ndikuara të bizneseve

- Shumica e bizneseve përmendin aspektet financiare si më të ndikuarat nga kriza, pasuar nga aspektet operative
- Aspekti financiar (humbjet financiare dhe mungesa e likuiditetit) duket se është problem kryesor për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Në anën tjetër, brenga kryesore e ndërmarrjeve prodhuese është humbja e kapaciteteve prodhuese.

Shitjet e ndërmarrjeve

- Gati 92% e bizneseve kanë deklaruar se shitjet janë zvogëluar si pasojë e krizës.
- Nga ato, 22% raportojne se shitjet janë zvogëluar me mbi 50% (48% shënojnë rënie më të lartë se 75%)
- Nga të dhënat e zbërthyera sipas madhësisë së kompanisë, duket se më të afektuarat nga rënia e nivelit të shitjeve janë ndërmarrjet mikro (62.1% kanë rënie mbi 50%) dhe ato të vogla (60.9% kanë shënuar përgjysmim të shitjeve).

Te gjeturat e studimit


Slajdet në vijim paraqesin të gjeturat e studimit për mostrën e plotë si dhe të zbërthyerat sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe sektorit specifik

1. Si do ta vlerësonit ndikimin e pandemisë COVID-19 në biznesin tuaj

95% të kompanive e kanë vlerësuar ndikimin si negative, e nga to:

58.6% si shumë negativ

37.3% si negativ



		Madhësia e biznesit				Total
		1-9 punetore	10-49 punetore	50-249 punetore	250+ punetore	
Vlerësimi_pandemia Si do ta vlerësonit ndikimin e pandemisë COVID19 në biznesin tuaj?	Negativ	39.6%	37.9%	35.4%	26.7%	37.3%
	Neutral	1.8%	1.9%	3.1%	3.3%	2.2%
	Nuk e di	1.2%	1.2%	1.0%	3.3%	1.3%
	Pozitiv	0.6%		1.0%	3.3%	0.7%
	Shumë negativ	56.8%	59.0%	59.4%	63.3%	58.6%
Total		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

1. Si do ta vlerësonit ndikimin e pandemisë COVID-19 në biznesin tuaj

Nëse e zbërthejmë vlerësimin në bazë të madhësisë së ndërmarrjes, del se ndikimi negativ i COVID-19 rritet me rritjen e madhësisë së kompanisë (madhësia për nga numri i të punësuarve)

1. Si do ta vlerësonit ndikimin e pandemisë COVID-19 në biznesin tuaj?

- Sipas sektorëve të ndërmarrjeve, ndikimi vlerësohet me si vijon:
 - Ndërtimtaria: 97.7% e vlerësojnë ndikimin si negativ (70.5% si shumë negativ)
 - Tregtia me pakicë: 97.9% negativ (67.7% si shumë negativ)
 - Tregtia me shumicë: 96.5% negativ (68.6% shumë negativ)
 - Prodhimtaria: 93.5% negativ (62.7% shumë negativ)


2. Si po e kryen kompania veprimtarinë e saj gjatë kësaj periudhe?

83.6% e ndërmarrjeve janë afektuar në aftësinë e tyre për të punuar, e nga to:

39% janë mbyllur tërësisht

30.7% punojnë me kapacitet të reduktuar

13.8% me orar të shkurtuar



		Madhësia e biznesit				Total
		1-9 punetore	10-49 punetore	50-249 punetore	250+ punetore	
Puna_pandemia Si po e kryen kompania veprimtarine e saj gjate kesaj periudhe?	është e mbyllur tërësisht	54.4%	36.6%	19.8%	26.7%	39.0%
	Nuk e di	3.0%	1.9%	1.0%	3.3%	2.2%
	Nuk ka ndonjë ndryshim	0.6%	1.9%	6.3%	3.3%	2.4%
	Punon me kapacitet të reduktuar	12.4%	32.3%	57.3%	40.0%	30.7%
	Punon me orar të shkurtuar	13.6%	16.8%	8.3%	16.7%	13.8%
	Të gjitha ose një pjesë e aktiviteteve kryhen nga shtëpia	16.0%	10.6%	7.3%	10.0%	11.8%
Total		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

2. Si po e kryen kompania veprimtarinë e saj gjatë kësaj periudhe?

Nëse e zërthejmë vlerësimin në bazë të madhësisë së ndërmarrjes, del se:

Ndërmarrjet mikro janë më të prekurat me mbyllje të plotë (54.4%)


Ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha janë detyruar të punojnë me kapacitet të reduktuar (57.3% dhe 40%)

2. Si po e kryen kompania veprimtarinë e saj gjatë kësaj periudhe?

- Sipas sektorëve të ndërmarrjeve, ndikimi vlerësohet me si vijon:
 - Ndërtimtaria:
 - 38.6% kanë ndërprerë veprimtarinë tërësisht
 - 27.3% punojnë me kapacitet të reduktuar
 - 18.2% punojnë me orar të shkurtuar
 - Tregtia me pakicë:
 - 47.9% kanë ndërprerë veprimtarinë tërësisht
 - 20.8% punojnë me kapacitet të reduktuar
 - 20.8% punojnë me orar të shkurtuar
 - Tregtia me shumicë:
 - 38.4% kanë ndërprerë veprimtarinë tërësisht
 - 34.9% punojnë me kapacitet të reduktuar
 - 18.6% punojnë me orar të shkurtuar
 - Prodhimtaria:
 - 36.3% kanë ndërprerë veprimtarinë tërësisht
 - 39.2% punojnë me kapacitet të reduktuar
 - 13.7% punojnë me orar të shkurtuar

3. A rrezikon COVID19 mbijetesën e biznesit tuaj?

60% e ndërmarrjeve mendojnë se kriza e shkaktuar nga COVID-19 rrezikon mbijetesës e tyre



		Madhësia e biznesit				Total
		1-9 punetore	10-49 punetore	50-249 punetore	250+ punetore	
Rreziku A rrezikon COVID19 mbijetesën e biznesit tuaj?	Jo	3.6%	3.1%	6.3%	10.0%	4.4%
	Nuk e di	3.0%	1.9%	2.1%	3.3%	2.4%
	Nuk mund të vlerësojë për momentin	28.4%	29.2%	46.9%	46.7%	33.8%
	Po	65.1%	65.8%	44.8%	40.0%	59.4%
Total		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

3. A rrezikon COVID19 mbijetesën e biznesit tuaj?

Nëse e zërthejmë vlerësimin në bazë të madhësisë së ndërmarrjes, del se ka korelacion të zhdrejtë në mes të madhësisë dhe rrezikut për mbijetesë:

Ndërmarrjet mikro dhe ato të voglat perceptojnë rrezikun më të madh ku mbi 65% e tyre kanë deklaruar se i është rrezikuar mbijetesë


Pak nën gjysma e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha konsiderojnë se ju cenohet mbijetesë (44.8% dhe 40%)

3. A rrezikon COVID19 mbijetesën e biznesit tuaj?

- Sipas sektorëve të ndërmarrjeve, ndikimi vlerësohet me si vijon:
 - Ndërtimtaria:
 - 75% konsiderojnë se i rrezikohet mbijetesa
 - 20.5% nuk mund të vlerësojnë për momentin
 - Tregtia me pakicë:
 - 57.3% konsiderojnë se i rrezikohet mbijetesa
 - 38.5% nuk mund të vlerësojnë për momentin
 - Tregtia me shumicë:
 - 54.7% konsiderojnë se i rrezikohet mbijetesa
 - 33.7% nuk mund të vlerësojnë për momentin
 - Prodhimtaria:
 - 56.6% konsiderojnë se i rrezikohet mbijetesa
 - 38.7% nuk mund të vlerësojnë për momentin

4. Si ka ndikuar COVID19 në numrin e të punësuarve tuaj?

29.2% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se qysh në javën e tretë të krizës numri i të punësuarve është zvogëluar



	Madhesia e biznesit				Total	
	1-9 punetore	10-49 punetore	50-249 punetore	250+ punetore		
Ndikimi_punesim Si ka ndikuar COVID19 ne numrin e te punesuarve tuaj?	është rritur			6.7%	0.4%	
	është zvogëluar	25.4%	25.5%	40.6%	33.3%	29.2%
	Ka mbetur i njëjtë	71.6%	72.7%	57.3%	56.7%	68.0%
	Nuk e di	3.0%	1.9%	2.1%	3.3%	2.4%
Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	

4. Si ka ndikuar COVID19 në numrin e të punësuarve tuaj?

Në bazë të përgjigjeve, 40.6% të ndërmarrjeve të mesme kanë deklaruar se kriza ka ndikuar në zvogëlimin e numrit të të punësuarve.

33.3% e ndërmarrjeve të mëdha kanë deklaruar se është zvogëluar numri i të punësuarve.

Impakti në numrin e të punësuarve duket të jetë pak më i ulët te ndërmarrjet mikro (25.4%) dhe ato të vogla (25.5%).

4. Si ka ndikuar COVID19 në numrin e të punësuarve tuaj?

- Sipas sektorëve të ndërmarrjeve, ndikimi vlerësohet me si vijon:
 - Ndërtimtaria:
 - 29.5% deklarojnë se është zvogëluar numri i të punësuarve
 - Tregtia me pakicë:
 - 28.1% deklarojnë se është zvogëluar numri i të punësuarve
 - Tregtia me shumicë:
 - 23.3% deklarojnë se është zvogëluar numri i të punësuarve
 - Prodhimtaria:
 - 24.5% deklarojnë se është zvogëluar numri i të punësuarve

4.1. Sa përqind të të punësuarve i keni larguar nga puna deri tani?

2,948 të punësuar deklarohen si të larguar nga puna në ndërmarrjet e anketuara, të cilat i janë përgjigjur kësaj pyetje.

4.6% të ndërmarrjeve të anketuara kanë deklaruar se i kanë larguar të gjithë të punësuarit.

	Madhesia e biznesit				Total
	1-9 punetore	10-49 punetore	50-249 punetore	4 250+ punetore	
Ende nuk kanë larguar asnjë punëtor nga puna	77.0%	78.9%	67.7%	80.0%	75.9%
Kanë larguar deri në 30% të të punësuarve	0.6%	8.7%	16.7%	10.0%	7.5%
Kanë larguar 30-50% të të punësuarve	8.5%	5.0%	3.1%	6.7%	6.0%
Kanë larguar mbi 50% të të punësuarve	13.9%	7.5%	12.5%	3.3%	10.6%

- Më së paku të punësuar janë larguar nga ndërmarrjet e mëdha – 10% e tyre kanë larguar deri 30% të fuqisë punëtore
- Largimet më të mëdha nga puna observohen të ndërmarrjet mikro dhe të vogla ku:
 - 8.5% e ndërmarrjeve mikro kanë larguar në mes të 30-50% të fuqisë punëtore, ndërsa 13.9% të tyre kanë larguar mbi 50% të të punësuarve
 - Ngjajshëm, 5% e ndërmarrjeve të vogla kanë larguar në mes 30-50% të të punësuarve, ndërsa 7.5% të këtyre ndërmarrjeve kanë larguar mbi 50% të fuqisë së tyre punëtore.

4.1. Sa përqind të të punësuarve i keni larguar nga puna deri tani?

	Ndërtimtaria	Tregtia me shumice	Tregtia me pakice	Prodhimtaria
Ende nuk kane larguar asnje punetor nga puna	72.1%	79.1%	76.8%%	80.8%
Kane larguar deri ne 50% te te punesuarve	18.6%	11.6%	11.6%	11.1%
Kane largar mbi 50% te te punesuarve	9.3%	9.3%	11.6%	8.2%

- Nëse shikohen sektorët, pasqyra është si vijon:
 - Ndërtimtaria: 27.9% kanë larguar të punësuar, ku 9.3% kanë larguar mbi 50% të të punësuarve
 - Tregtia me shumicë: 20.9% të ndërmarrjeve kanë larguar të punësuar, ku 9.3% kanë larguar mbi 50% të fuqisë punëtore
 - Tregtia me pakicë: 23.2% kanë raportuar se kanë larguar të punësuar, ku 11.6% të tyre kanë larguar mbi 50% të të punësuarve
 - Prodhimtaria: 19.2% kanë raportuar largime nga puna, ku 8.2% e tyre kanë larguar mbi 50% të të punësuarve


5. Në cilat aspekte ndikon COVID19 në biznesin tuaj?

Shumica e bizneseve përmendin aspektet financiare si më të ndikuarat nga kriza:

77.78% Humbje financiare
43.72% Mungesë likuiditeti

Pasuar nga aspektet operative si:

39.37% Jo efikasitet në punë
26.81% kapacitetet prodhuese



	Madhesia e biznesit				Total
	1-9 punetore	10-49 punetore	50-249 punetore	4 250+ punetore	
Joefikasitet në punë	30.2%	37.3%	41.7%	33.3%	35.3%
Mungesë e likuiditetit	26.0%	40.4%	59.4%	46.7%	39.5%
Humbje financiare	66.3%	73.9%	70.8%	63.3%	69.7%
Humbje të kapaciteteve	13.6%	35.4%	28.1%	10.0%	24.1%
Përkushtim i ulët i punonjësve	14.8%	26.1%	31.3%	16.7%	22.4%
Ulje e mundësive të eksportit	11.2%	32.9%	30.2%	10.0%	22.8%
Tjeter	10.1%	6.8%	7.3%	6.7%	8.1%

5. Në cilat aspekte ndikon COVID19 në biznesin tuaj?

Kriza sipas përgjigjeve në aspektin e operacioneve të ndërmarrjeve duket se ka ndikuar më së shumti në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Aspekti financiar (humbjet financiare dhe mungesa e likuiditetit) duket se është problem për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

	Ndertimtaria	Tregtia me shumice	Tregtia me pakice	Prodhimtaria
Joefikasitet në punë	38.64%	33.72%	38.54%	31.60%
Mungesë e likuiditetit	31.82%	45.32%	40.63%	38.68%
Humbje financiare	63.64%	74.42%	76.04%	67.45%
Humbje të kapaciteteve prodhuese	31.82%	30.23%	23.96%	48.11%
Përkushtim i ulët i punonjësve	29.55%	12.79%	21.88%	24.06%
Ulje e mundësive të eksportit	34.09%	29.07%	21.88%	41.01%
Tjeter	4.55%	9.30%	8.33%	7.08%

5. Në cilat aspekte ndikon COVID19 në biznesin tuaj?



Nëse shikojmë sektorët në të cilët përfaqësimi i respondentëve është më i madh, del se tregtia ka cekur humbjet financiare dhe likuiditetin si probleme më të theksuara.

Në anën tjetër, brenga kryesore e ndërmarrjeve prodhuese është humbja e kapaciteteve prodhuese.

6. Si janë afektuar shitjet tuaja nga COVID19?

Gati 82% e bizneseve kanë deklaruar se shitjet janë zvogëluar si pasojë e krizës.

Nga ato, 57.7% raportojnë se shitjet janë zvogëluar mbi 50% (39% shenojnë rënie më të lartë se 75%)



		Madhësia e biznesit				Total
		1-9 punetore	10-49 punetore	50-249 punetore	250+ punetore	
Shitjet_zvogelim janë zvogëluar shitjat tuaja?	0-10%	3.0%	2.5%	5.2%		3.1%
	10-15%	1.8%	0.6%	4.2%	6.7%	2.2%
	15-25%	3.0%	6.8%	5.2%		4.6%
	25%-50%	10.1%	14.9%	18.8%	16.7%	14.0%
	50-75%	15.4%	19.9%	19.8%	26.7%	18.6%
	75-100%	46.7%	41.0%	27.1%	23.3%	39.0%
	Nuk e di	20.1%	14.3%	19.8%	26.7%	18.4%
Total		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

6. Si janë afektuar shitjet tuaja nga COVID19?

Nga të dhënat e zbërthyera sipas madhësisë së kompanisë, duket se më të afektuarat nga rënia e nivelit të shitjeve janë ndërmarrjet mikro (62.1% kanë rënie mbi 50%) dhe ato të vogla (60.9% kanë shenuar përgjysmim të shitjeve).


Mbi 46% e Ndërmarrjeve të mesme raportojnë se kanë rënie të shitjeve mbi 50%, derisa ky proporcion te ndërmarrjet e mëdha është 50% e respondentëve.

6. Si janë afektuar shitjet tuaja nga COVID19?

	Ndertimaria	Tregtia me shumice	Tregtia me pakice	Prodhimtaria
Ndermarrjet te cilave I jane zvogeluar shitjet	81.82%	83.72%	85.42%	81.60%
Ndermarrjet qe kane deklaruar se shitjet kane rene mbi 50%	70.45%	59.30%	63.54%	58.02%


- Nëse shikohen sektorët, mbi 80% e ndërmarrjeve të anketuara nga të gjitha sektorët deklarojnë se kanë shënuar rënie të shitjeve.
- Shitjet kanë rënë sidomos në sektorin e ndërtimeve – ku mbi 70% të ndërmarrjeve deklarojnë se kanë shënuar rënie të shitjeve në shkallë më të madhe se 50%
- Rreth 60% e ndërmarrjeve nga sektorët e tjera poashtu deklarojnë se shitjet kanë rënë për më shumë se 50%

7. Sa jeni të kënaqur me qartësinë e vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat kufizuese pas shpërthimit të pandemisë COVID19?




- 76% të ndërmarrjeve të anketuara shprehen se janë të kënaqura me qartësinë e vendimeve të Qeverisë së Kosovës.

8. Si do t'i vlerësonit procedurat dhe sjelljen e zyrtarëve shtetërorë të Republikës së Kosovës gjatë importit dhe eksportit?



Nuk aplikohet në veprimtarinë tonë	21.3%
Nuk e di	8.6%
Procedurat dhe sjellja e zyrtarëve është mbi standardin e atyre të rajonit	17.5%
Procedurat janë më të avancuara dhe më fleksibile por sjellja e zyrtarëve	1.5%
Procedurat janë më të ndërlukuara por sjellja e zyrtarëve është më	11.6%
Procedurat janë uniforme me ato të rajonit por sjellja e zyrtarëve është joprofesionale	8.8%
Të ngjashme me ato të rajonit	30.7%

	Madhesia e biznesit				TOTAL
	1-9 punetore	10-49 punetore	50-249 punetore	250+ punetore	
Masat lehtësojnë në masë të madhe vështirësitë e biznesit	6.5%	5.6%	4.2%	6.7%	5.7%
Masat lehtësojnë mesatarisht vështirësitë e biznesit	21.9%	19.9%	20.8%	23.3%	21.1%
Masat lehtësojnë shumë pak vështirësitë e biznesit	35.5%	44.7%	47.9%	36.7%	41.4%
Masat nuk lehtë«sojnë» aspak vë«shtirë«sit e biznesit	8.3%	4.3%	7.3%	3.3%	6.4%
Nuk e di	27.8%	25.5%	19.8%	30.0%	25.4%



9. Si do t'i vlerësonit masat e deklaruar ekonomike?



Analiza e të dhënave është realizuar pro-bono nga:

